REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 264/19
Datë/Datum. 17.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – RepublicofKosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit AK –KOMUNA E PRIZRENIT	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	*Xhevdet Bushi – Ekspert i jashtëm shqyrtues i prokurimit*		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me:**Nr.264/19nga OE. "IsCompany"–Prizren**		
Datë	17.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e **dt.30.05.2019 me nr.264/19të parashtruar ngaOE."IsCompany" –Prizren** lidhur meaktivitetine prokurimit **"Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve, sheshevë, hapësirave të gjelbërura, shtratit të lumbardhit, largimi i borës në qytet dhe fshatrat e komunës së Prizrenit"** me nr. të prokurimit: **622-18-9669-211**, iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues (AK) - KOMUNA PRIZREN.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- ***Autoritetit Kontraktues – KOMUNA E PRIZRENIT.***
- ***Panelit Shqyrtues – OSHP***
- ***OE ankues*** - **"Is Company"shpk.**

Republika e Kosovës
Republika Kosova – RepublicofKosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PROCUREMENT REVIEË BODY

RAPORTIIEKSPERTIT SHQYRTUES

		05.06.2019		**05.06.2019**		**17.06.2019**
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të eksp.*		*data e fillimit të ekspertizës*		*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

1) Me datë **30.05.2019 me nr. 264/19 të parashtruar ngaOE."IsCompany"- Prizren**
2) lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve, shesheve, hapësirave të gjelbërura, shtratit të lumbardhit, largimi i borës në qytet dhe fshatrat e komunës së Prizrenit"** me nr. të prokurimit: **622-18-9669-211**, iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PRIZRENIT**

N.111,LPP-Operatori Ekonomik AnkuesOE "IsCompany"– Prizren (Nr.264/19)

Pikat e Ankesës:

- Njoftimipërkontratëështëpublikuar me datë 27.12.2018.
- AfatipërDorëzimtëofertës ka qenëderi me 08.02.2018
- Kriterpërdhenietëkontratës ka qenëtenderiipërgjegjshëm me çmiminmëtëulët
- Kërkesapërrishqyrtim me dt:01.03.2019
- Vendimipërrefuzimtëkërkesëspërrishqyrtim me dt:05.03.2019
- Vendimii OSHP-së Nr.108/19 Dt:02.05.2019
- Njoftimimbivendimin e AK-së: 14.05.2019
- Letrastandardepërtenderuestëeliminuar dt:14.05.2019
- Kërkesapërrishqyrtim dt:17.05.2019
- Vendimii AK-sëpërrefuzimtëkërkesëspërrishqyrtim dt:21.05.2019

Dispozitat e shkelura (pretendimet ankimore)nga AK sipas OEankues (Nr.264/19)janë:
Neni 1 i LPP-së **Neni 7 i LPP-së** **Neni 56.3 i LPP-së** **Neni 59 i LPP-së** **Neni 60 i LPP-së** **Neni 61 i LPP-së** **Neni 62 i LPP-së** **Neni 44.7 dhe 8 i RRUOPP** **Rregullorja për çmime jo normalisht të ulëta** **Vendimi PSH. Nr.108/19 i dt:02.05.2019**
Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet
Të nderuar, ju rikujtojmë se neve me vendimin Psh.nr.108/19 të dt:02.05.2019 na është aprovuar ankesa dhe lënda në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është kthyer në rivlerësim. Në vendimin e OSHP-së, është konstatuar se autoriteti kontraktues nuk e ka parashikuar vlerën e kontratës sipas loteve, por e kanë parashikuar vlerën vetëm në total dhe duke u bazuar në këtë fakt, paneli shqyrtues ka konstatuar se AK-ja nuk e ka respektuar nenin 56.3 të LPP-së, me rastin e eliminimit tonë në herën e parë. Gjithashtu në vendimin e OSHP-së, është konstatuar se në bazë të tabelës së Rregullorës për çmime jonormalisht të ulëta, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë për Lot 1, "Eingcom&Elbau" dhe ofertuesi i dytë me çmim më të ulët "Ekoregjioni" janë më çmime jo normalisht të ulëta. Pas kthimit të lëndës në rivlerësim, autoriteti kontraktues ka vepruar përsëri në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe në kundërshtim me vendimin e OSHP-së nr.108/19 të dt:02.05.2019 duke e rekomanduar për kontratë të njëjtin operator ekonomik për Lot 1, i cili operator ekonomik ka ofruar çmim jonormalisht të ulët, si në vlerën totale, ashtu edhe në shumë pozicione, ndërsa e kanë anuluar lotin III (tre) pa ndonjë bazë ligjore duke na diskriminuar neve. Fillimisht ju sqarojmë, se autoriteti kontraktues tek njoftimi për kontratë në nenin II.1.10) ka paraparë që Vlera e parashikuar e kontratës: është 4.000.000,00, ndërsa në dosje të tenderit askund nuk është parashikuar vlera e përgjithshme, e as e veçantë për secilin lot. Gjithashtu në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, ne jemi shpallur të papërgjegjshëm për tejkalim të çmimit të parashikuar, edhe pse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, e përderisa i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes ne duhet të shpallemi të përgjegjshëm. Pra në këtë rast nuk ka tejkalim të çmimeve sepse ekziston një planifikim i përgjithshëm për tri lotet. Autoriteti kontraktues për Lot 1 e ka shpall fitues përsëri operatorin ekonomik "EingCom&ElbauShpk me çmim prej 744.426.00 €, i cili operator ekonomik ka ofertuar me çmim jo normalisht të ulët sipas rregullores për **çmime jonormalisht të ulëta** dhe **sipas pozicioneve**. Në bazë të tabelës së parashikuar tek rregullorja për çmim jonormalisht të ulët, kur bëhet analizimi dhe përllogaritja e çmimeve të operatorëve ekonomik ofertues, rezulton se operatori ekonomik EingCom&ElbauShpk i rekomanduar për kontratë për Lot 1 dhe operatori ekonomik i dyti i renditur me çmim në këtë lot, Kompania regjionale e

Mbeturinave Ekoregjioni kanë ofertuar me çmim jonormalisht të ulët (këtë e ka konstatuar edhe vendimi i panelit shqyrtues nr.108/19.
Duke u bazuar në këto kalkulime dhe në vendimin e panelit shqyrtues, atëherë ne është dashur të shpallemi fitues i këtij loti, sepse pas këtyre dy ofertuesve që kanë çmime jonormalisht të ulëta, ne jemi operatorë ekonomik i përgjegjshëm me çmim më të lirë.
Autoritet kontraktues nuk na ka shpallur fitues neve në këtë Lot, duke u bazuar në kërkesa që nuk kanë qenë në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë (tejkalim të çmimeve, ndërsa nuk ka pasur planifikim të veçantë për Lote) por është lënë hapësira për të manipuluar me rastin e dhënies së kontratave për lote (kjo është konstatuar me vendimin e panelit shqyrtues).

Autoriteti kontraktues hapur e ka favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë, sepse e ka shpallur fitues në zonën e parë, ku zona e parë ka 34 km, zona e dytë 31 km dhe zona e tretë 19 km, sipërfaqe të gjelbruara 62000 m^2 zona e parë, zona e dytë 165000 m^2 dhe mirmbajtja e lumbardhit 2200 m^2, dhe zona e tretë 125000 m^2 sipërfaqe të gjelbëruara. Pra është shpallur fitues në zonën ku ka punë më shumë dhe fitim më i madh normalisht, edhe pse ky operator ekonomik ka ofertuar me çmim më të lirë në zonën 3 prej të gjithë ofertuesve dhe ka mundur të shpallet fitues. Këtë veprim AK-ja e ka ndërmarr kuptohet, vetëm që ne mos të jemi fitues i këtij loti (Lot 1).

Duke pasur për bazë këtë fakt, autoriteti kontraktues në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe në kundërshtim me vendimin e panelit shqyrtues, duke dashur ta favorizojë operatorin ekonomik EingCom&ElbauShpk, nuk e kanë shpallur fitues në Lot 3, i cili operator ekonomik ka ofertuar me çmimin më të lirë, se secili ofertues, pra në vlerë prej :440.361.00 €, por është shpallur fitues në Lot 1, ku ka ofertuar me çmim më të lartë se në Lot 3, pra në lot 1 ka ofertuar me çmim prej:875.078.88 €. Këtë veprim, autoriteti kontraktues e ka ndërmarr edhe me qëllimin që, ne mos të shpallemi fitues në asnjërin Lot, sepse nëse kur operatorët e lartpërmendur do të konsideroheshin me çmime jonormalisht të ulëta (për Lot 1) atëherë ne do të duhej të shpalleshim fitues në këtë lot me çmimin prej:1.552.698.80 €.

OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmime jonormalisht të ulëta edhe në shumë pozicione, të cilat mund ti verifikoni edhe ju si OSHP, si p.sh te **tabela C** te mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta në qytet:**pastrimi**, **kositja**, dhe **krasitja**, tek 23 pozicione ka ofruar çmime prej **0.02 cent** (si ka mundësi të kryehen këto shërbime dhe punë me 0.02 cent ?).
Pastaj tek tabela **A**, nr 2 Kategoria e II-fshirja 12 herë në muaj, **larja-spërkatja tetë** (8) **herë në muaj**, dhe largimi i borës për trotuare në 11 pozicione ka ofruar çmime prej 0.**10 cent**, ndërsa për rrugë 0.30 cent etj
Tek tabela D (shërbime të veçanta) komplet pozicionet i ka me çmime jonormalisht të ulëta, madje janë çmime absurde, të pa imagjinueshme dhe manipulative.

Tek tabela E (shërbime të veçanta) komplet pozicionet i ka me çmime jonormalisht të ulëta, madje janë çmime absurde dhe të pa imagjinueshme.
Pra pjesën më të madhe të pozicioneve (në ofertë) ka ofruar çmime jonormalisht të ulëta, çmime manipulative që nuk mund të arsyetohen në asnjë mënyrë. Këto çmime nuk ka asnjë mundësi teorike të arsyetohen, për shkak se nuk kanë mbështetje në asnjë manual të çmimeve referente në Kosovë.

Sa i përket Operatorit ekonomik **"Kompania regjionale e Mbeturinave Ekoregjioni"** i rendituar **i dyti** me çmim më të lirë në këtë lot (i konstatuar me vendim të OSHP-së se ka çmime jonormalisht të ulëta) po ashtu ka ofertuar edhe në pozicione me çmime jonormalisht të ulëta dhe njëkohësisht çmime manipulative si psh Në tabelen A nr.1 dhe Nr.2 komplet pozicionet kanë çmime jonormalisht të ulëta. Ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm edhe për arsye se tek tabela C në 23 pozicione ka ofertuar me më shumë se dy numra pas pikës dhjetore **(0.012)**, kurse kjo nuk ka qenë e parashikuar në dosje të tenderit dmth nuk ka qenë e lejuar, ndërsa neni 18.3 pjesa C e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP) shkruan qartë si në vijim "Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas

pikës dhjetore. Nëse OE ofron çmim me me shume se dy (2) numra pas pikës dhjetore , oferta e tille do te konsiderohet e papërgjegjshme. Ne rast se AK lejon çmime me më shume se (2) numra pas pikës dhjetore, atëherë AK duhet të cekë këtë decidivisht në Dosjen e tenderit.
Në këtë rast lejimi i ofertimit me më shumë numra pas pikës dhjetore nuk është parashikuar në dosje të tenderit, prandaj ky OE konsiderohet i papërgjegjshëm.

Vetëm një analizë e thjeshtë mjafton të bëhet dhe të vërtetohen çmimet jonormalisht të ulëta dhe manipulative të dy OE me çmim më të ulët, shiko çmimet e OE të rekomanduar për kontratë në tabelën D dhe krahaso me çmimet e "Kompanisë regjionale të Mbeturinave Ekoregjioni se sa dallojnë.

Në vijim është tabela me përllogaritjet ku shihet se OE i rekomanduar për kontratë dhe OE i dyti me çmim më të lirë, kanë ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta.

Nr.	Lot 1			
	A	B	C	D
1	**kushti 1** - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta	**Pranuar 4 oferta**		
2		1 Kompaninë regjionale të Mbeturinave Ekoregjioni	875,078.88	
3		**2 NSh Shërbimi Tirana P.NR**	**2,500,316.00**	
4		3 IscompanyShpk	1,745,446.20	
5		4 EingCom&ElbauShpk	744,426.00	
6		5		
7		6		
8		Total (C2+C3+C4+C5)	5,865,267.08	
9		**mesatarja (C4/6)**	**1,466,316.77**	
10	**kushti 2** - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	**pragu 30% (mesatarja /1.3)**	**1.127.935.98**	ne ketë rast vetëm oferta 1 dhe 4 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11	**kushti 3** – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	**pragu 10% (oferta e dyte /1.1) 1.745.446.20/1.1**	**1.586.769.27**	ne ketë rast oferta me nr 4 përmbush edhe kushtin e trete

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se **3 oferta**	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar**	Oferta e dyte plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se

	i tenderëve të përgjegjshëm	mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih pragun C11
Konkludim	**Oferta me nr. rendor 1 dhe 4 plotësojnë 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulët**	

Ne me dt:17.04.2019 kemi pasur qasje në dokumente dhe e kemi parë, se AK-ja ka kërkuar sqarime nga të dy operatorët ekonomik me çmim më të lirë, se si i arsyetojnë çmimet e lira për Lot I, ndërsa me dt:13.05.2019 i keni pranuar sqarimet në lidhje me kërkesën tuaj, e të cilat sqarime AK-ja i ka pranuar si të arsyeshme.

Sa i përket OE të rekomanduar për kontratë, në sqarimet që i ka bërë vërëhet qartë se janë sqarime paushalle dhe abstrakte, të padefinuara në detaje për të bindur autoritetin kontraktues.
Neni 4.2 i Rregullorës për çmime jonormalisht të ulëta e parasheh në këtë mënyrë "Në rast se një tender (**apo një pozicion i tenderit**) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".

Pra kjo dispozitë flet edhe për pozicionet e tenderit dhe parasheh që duhet të zbërthehen detajet e pjesëve relevante të tenderit.
Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dhënë asnjë shpjegim për pozicionet të cilat ne i kemi cekur më lartë, e që janë çmime jashtëzakonisht çmime jonormale, madje janë çmime manipulative si p.sh çmimet tek te tabela C te mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta në qytet:pastrimi, kositja, dhe krasitja, tek 23 pozicione ka ofruar çmime prej 0.02 cent (si ka mundësi të kryehen këto shërbime dhe punë me 0.02 cent ?). Për këto pozicione OE i rekomanduar për kontratë është dashur të jep shpjegime se si mund të realizojë kryerjen e këtyre punëve-shërbimeme me këtë çmim, dhe autoriteti kontraktues është dashur të merr përgjigje- sqarime për këto pozicione dhe për shumë pozicione tjera, e jo ti pranojë sqarimet abstrakte për pagesat e punëtorëve, shpenzimet për makineri etj, sepse këto nuk janë çështje relevante dhe kontestuese.

Pastaj tek tabela A, nr 2 Kategoria e II-fshirja 12 herë në muaj, larja-spërkatja tetë (8) herë në muaj, dhe largimi i borës për trotuare në 11 pozicione ka ofruar çmime prej 0.10 cent, ndërsa për rrugë 0.30 cent etj. Autoriteti kontraktues është dashur të kërkojë sqarime se si implementohen këto pozicione me këto çmime. Pra edhe për këto pozicione nuk është dhënë asnjë sqarim detal, siç parashihet në nenin 4.2 të Rregullorës për çmime jonormalisht të ulëta.
Pastaj tek tabela E, përshkrimi nr 4- "Grumbullimi, trasporti dhe deponimi i mbeturinave inerte nga pikat e egra nëpër qytet dhe periferi, sips nevojë" është ofruar çmimi për një ton 0.20 cent. Si mund të arsyetohet ky çmim?. Natyrisht në pamundësi të dhëniës së sqarimeve detale për pozicione, OE i rekomanduar për kontratë ka dhënë shpjegime për paga të punëtorëve. Gjithashtu edhe te shumë e shumë pozicione tjera, ky operator ekonomik ka ofruar çmime jonormalisht të ulëta.

Përfundimisht OE i rekomanduar për kontratë për Lot I, nuk ka bërë asnjë sqarim detal siç parashihet në Rregullorën për çmime jonormalisht të ulëta, prandaj rezulton se OE i rekomanduar në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant, nuk ka mundur ti sqarojë dhe të dëshmojë se si mund ti kryejë punët dhe shërbimet për pozicione me çmimet e ofruara.

Të njëjtin pretendim e kemi edhe për operatorin ekonomik të renditur i dyti me çmim "Kompania regjionale e Mbeturinave Ekoregjioni", sepse edhe ky operator ekonomik nuk ka mundur të bëjë asnjë arsyetim faktik dhe real se si mund ti kryej punët dhe shërbimet me çmimet e ofruara për pozicione edhe pse për këtë operatorë ekonomik janë

kërkuar pa nevojë dhe pa arsye shpjegime, sepse ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm për faktin se tek pjesa C në 23 pozicione ka ofertuar me më shumë se dy numra pas pikës dhjetore (0.012), ndërsa kjo nuk ka qenë e parashikuar në dosje të tenderit.

Autoriteti kontraktues nuk ka parashikuar në dosje të tenderit edhe në sa lote mund të shpërblehen me kontratë operatorët ekonomik, e në këtë mënyrë ka vepruar në kundërshtim edh me me nenin 27 A të LPP-së, sepse aty shkruan qartë "Autoritetet kontraktuese do të përcaktojnë dhe do të paraqesin në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jo-diskriminuese apo rregullat për shpërblimin e loteve të ndryshme, ku aplikimi për përzgjedhjen e kritereve për shpërblim do të rezultonte në shpërblimin e një tenderuesi me më shumë lote se sa numri maksimal".

Për lot 2, Autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik "Kompaninë regjionale të Mbeturinave Ekoregjioni" me çmim 823.118.43 €, ndërsa ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm për shkak se vërtetimin e ATK-së e ka ofruar me dt:27.02.2019, kurse shpallja e tij fitues është bërë me dt:25.02.2019, e që kjo bie në kundërshtim me nenin 65 paragrafi 4.8 dhe paragrafi 5 i këtij neni.

Poashtu veprimet e AK-së janë në kundërshtim edhe me nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për Prokurim Publik (RrUOPP) ku shkruan:
vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim qe ta shpërblej me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit te njoftimit për dhënie të kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo me pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do te konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të inicioj procedurën për diskualifikim ne përputhje me nenin 99.2 te LPP-se.

Pra kjo dispozitë është shumë e qartë dhe OE i rekomanduar për kontratë për Lot 2 është dashur të eliminoj këtë operator ekonomik, por çuditërisht e ka favorizuar në këtë mënyrë duke ja pranuar vërtetimin e ATK-së në kundërshtim me dispozitën e lartpërmendur dy ditë pas njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues (pra njoftimit për dhënie të kontratës), duke vepruar edhe në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, pra duke vepruar në mënyrë favorizuese për OE e rekomanduar për kontratë dhe njëkohësisht në mënyrë diskriminuese ndaj neve.

Gjithashtu edhe në FDT tek neni 6.4 shkruan qartë "Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës.Në rast të dështimit në dorëzim të dokumentave të tilla,tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar.

Për Lot 3, autoriteti kontraktues e ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se të gjithë ofertat e kanë tejkaluar vlerën e parashikuar të buxhetit, mirëpo kjo arsye nuk është e qëndrueshme, sepse në dosje të tenderit nuk ka pasur parashikim të vlerës dhe të çmimeve për secilin Lot, por ka pasur parashikim të përgjithshëm për të tri lotet, mirëpo këtë veprim AK-ja e ka ndërmarr me të vetmin qëllim që, ne mos të shpallemi fitues sepse operatori ekonomik EingCom&ElbauShpk dhe operatori ekonomik Kompania regjionale e Mbeturinave Ekoregjioni kanë ofertuar me çmim jonormalisht të ulët sikurse në Lot 1, kjo mund të vërtetohet me përllogaritjen tabelare, ndërsa ne jemi me çmim më të ulët se operatorët ekonomik tjerë dhe natyrisht ne është dashur të shpallemi fitues të këtij tenderi (Loti III).
Pra autoriteti kontraktues ka vepruar në mënyrë kundërligjore duke manipuluar në kalkulimin e loteve për dhënie të kontratës.

Për lot III anulimin e këtij loti, AK-ja e ka bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin

44.7 dhe 8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP) sepse asnjëri nga kushtet që parashihen në këto dispozita nuk janë përmbushur.

Në vijim është tabela ku vërtetohet se dy operatorët ekonomik me çmim më të ulët kanë ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta.

Nr.	Lot 1			
	A	B	C	D
1	**kushti 1** - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta	**Pranuar 4 oferta**		
2		1 Kompaninë regjionale të Mbeturinave Ekoregjioni	669.331,60	
3		**2 NSh Shërbimi Tirana P.NR**	**2.008.660,00**	
4		3 IscompanyShpk	1.552.698,80	
5		4 EingCom&ElbauShpk	440.361,00	
6		5		
7		6		
8		Total (C2+C3+C4+C5)	4,671.051.40	
9		mesatarja (C4/6)	1,167,762.85	
10	**kushti 2** - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	898,279.11	ne ketë rast vetëm oferta 1 dhe 4 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11	**kushti 3** – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	pragu 10% (oferta e dyte /1.1)	1,411.544.36	ne ketë rast oferta me nr 4 përmbush edhe kushtin e trete

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se **3 oferta**	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 4 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve** të përgjegjshëm	Oferta e dyte plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih pragun C11
Konkludim	**Oferta me nr. rendor 1 dhe 4 plotësojnë 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulët**	

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u përmendën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është marr parasysh edhe neni 7 i këtij ligji, sepse ne jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa janë favorizuar operatorët ekonomik të rekomanduar për kontratë. Në të njëjtën kohë është vepruar edhe në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së, sepse jemi eliminuar për kërkesa që nuk kanë qenë pjesë e dosjes së tenderit.
Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 61 i LPP-së dhe njëkohësisht edhe rregullorja për çmime jonormalisht të ulëta. Poashtu nuk është zbatuar vendimi i OHP-së nr.108/19 të dt:02.05.2019, sepse përëseri jemi eliminuar për kërkesa që nuk kanë qenë në dosje të tenderit.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga OSHP-ja, që Ankesën tonë ta shqyrton në detaje dhe të nxjerrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "IsCompany"SH.P.K-Prizren për Lot 1, 2 dhe 3,
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi për dhënie të kontratës për Lot 1 dhe 2,
ANULOHET, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit për Lot 3,
DETYROHET, autoriteti kontraktues që të bëjë rivlerësimin e ofertave për të tri Lotetkonform dispozitave të LPP-së dhe konform kërkesave të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

--

KRITERET E KËRKUARA:

Kërkesat e përshtatshmërisë: **Kërkesat:** **a).Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04/L-042.për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 .Neni 65.** **b)Në dokument nga Administra Tatimore e vendit tuaj të themelimit,se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.** **c)Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush"Kërkesat e përshtatshmeris" të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës** **d një dëshmi se ju keni përmbushë obligimet e tatimit në pronë së paku deri në muajin paraprak nga data e hapjes së ofertave**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **a. Deklarata nën betim e cila është pjesë e DT të plotësohet nënshkruhet dhe vuloset në original** **b).Vërtetim nga Administrata Tatimore (kopje).** **c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Qështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar/noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit).** **D. Vërtetimi i tatimit në pronë** **Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues,para publikimit të dhënies së kontratës.Në rast të dështimit në dorzimë të dokumentave të tilla,tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar**
Përshtatshmëria profesionale **Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe /apo Regjistrin e**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1:Certifikata e regjistrimit të**

ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit: Kërkesa 2.Regjistrimi i Numrit Fiskal: Kërkesa 3 OE duhet të jetë i regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH së Kërkesa 4. OE duhet të jetë I licencuar nga MMPH	biznesit me informatat për biznesin (kopje). Evidenca 2: Certifikata e numrit fiskal Evidenca 3:Qertefikata e TVSH-së Evidenca 4. Licenca e lëshuar nga MMPH për natyrës e kontratës e cila është valide.
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare N/A	
3. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjat tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se Loto 1= 1. 500.000,00 € Loto 2= 1.700.000,00 € Loto 3= 1.300.000,00 €	Evidenca 1 Pasqyrat e qarkullimit financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.
Kapaciteti teknik dhe professional Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se Loto 1= 750.000,00 € Loto 2= 800.000,00 € Loto 3= 650.000,00 € Kërkesa 2 për loto 1. a. Në kuadër të stafit duhet të emrohet me vendim menaxheri për këtë projekt i cili duhet të jetë Inxhinjer i diplomuar i ndërtimtarisë ose master me jo më pak se 5 vite pune në profesion. b. së paku 25 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Dëshmia 1 Lista e projekteve te ngjashme vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, kurse kopje për dosien në kopje fizike, të deshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve (kopje). Dëshmija 2 a. Nën pikën a Diploma e fakultetit kopje, referencat për periudhën e kaluar në profesion së paku për 5 vite, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit me OE për këtë projekt, b. Nën pikën b kontratat e punës ose kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt. c. pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë libreza të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, pajisjet tjera duhe të sjellë dëshmi mbi pronësinë e tyre ose dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve

c. Atocisternë (Autobot) – 5 - 10 ton 3 copë d. kamiona me plugje për bore 1 deri 5 ton 7 copë e. Autofshisa për trotuare1 deri 1.5 ton 3 copë ë makina për kositje, krasitje etj: standard 6 copë f. Kamionet për mbeturina nga parqet etj 2 ton – 1 copë Kërkesa 2 për loto 2. a. Në kuadër të stafit duhet të emrohet me vendim menaxheri për këtë projekt i cili duhet të jetë Inxhinjer i diplomuar i ndërtimtarisë ose master me jo më pak se 5 vite pune në profesion. b. së paku 25 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike c. Atocisternë (Autobot) – 5 - 10 ton 3 copë d. kamiona me plugje për bore 1 deri 5 ton 7 copë e. Autofshisa për trotuare1 deri 1.5 ton 3 copë ë makina për kositje, krasitje etj: standard 6 copë f. Kamionet për mbeturina nga parqet etj 2 ton – 1 copë Kërkesa 2 për loto 3. a. Në kuadër të stafit duhet të emrohet me vendim menaxheri për këtë projekt i cili duhet të jetë Inxhinjer i diplomuar i ndërtimtarisë ose master me jo më pak se 5 vite pune në profesion. b. së paku 25 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike c. Atocisternë (Autobot) – 5 - 10 ton 3 copë d. kamiona me plugje për bore 1 deri 5 ton 7 copë e. Autofshisa për trotuare1 deri 1.5 ton 3 copë ë makina për kositje, krasitje etj: standard 6 copë f. Kamionet për mbeturina nga parqet etj 2 ton – 1 copë VËREJTJE: Mbështetur në udhëzimin administrativ	

të lëshuar nga KRPP, tenderat me vlerë të madhe për punë, shërbime ose furnizim, dorëzohen vetëm në formë elektronike te faqja e eprokurimit.	

A. **një deklaratë e qartë** ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës
B. **një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët**, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;
C. **një deklaratë të nënshkruar** nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe
D. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të **jenë të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.
E. **Operatoret ekonomik janë te obliguar qe regjistrohen ne platformën e E-prokurimit ne adresën: ëëë.e-prokurimi.rks-gov.net**
F. **OE janë te obliguar qe dosjen ne emrin e vet ta tërheqin nga kjo platformë.**

a) **një deklaratë** ku deklarojnë nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatëse të prokurimit, dhe

b) Të gjithë nenkontraktorët do të **jenë të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.

Tenderuesi duhet të depozitoj sigurimin e tenderit.

Shuma e Sigurimit të Tenderit: N/A

Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% të vlerës se kontratësper 37 muaj.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 27.12.2018
Lloji i procedurës së aplikuar:.....Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....sherbime,Vlera e madhe,
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave:.....08.02.2019
Data e hapjes së ofertave:.....08.02.2019
Kërkesa per rishqyrtim : 17.05.2019
Kriteri për dhënie të kontratës.....tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

1.Përgjigje e AK-së për kërkesën për rishqyrtim

- **VENDIM I REFUZIMIT – datë 21.05.2019**

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi	LOT 1 Çmimi €	LOT 2 Çmimi €	LOT 3 Çmimi €	Vërejtje
1.	K.Regjionale e mbeturinave EKOREGJIONI	Prizren	875,078.88	823,118.43	669,331.60	Jo
2.	NSH. "Sherbimi"	Prizren	2,500,316.00	1,881,206.72	2,008,660.00	Jo
3.	"IsCompany" shpk	Prizren	1,745,446.20	2,361,794.56	1,552,698.30	Jo
4.	Grupi i Operatoreve "Eingcom" & "El-bau"	Podujevë	744,426.00	1,190,050.80	440,361.00	Jo

Komisioni i ri-vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit ri-vlerësues.
Autoriteti Kontraktues për ri-vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Laura Suka– Kryetar i komisionit
- Perparim Shala – Anëtar i komisionit
- GezimGerqi– Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit ri-vlerësues (14.05.2019):

Deklaratë e Komisionit

OE. "Ekoregjioni" i ka plotësuar kriteret e kërkuara vetëm për nje Loto dhe shpërblehet me lotin e dyte, me çmimin e ofertuar prej 823,118.43 €.
Grupi i OE "EingCom" & "El-bau" shpk i ka plotësuar kriteret e ofertës vetëm per nje Loto dhe eshte shpërblyer vetëm me loten e parë me çmimin ofertues prej 744,426.00 euro.
LOTi i trete te ritenderohet.

Konstatimet e ekspertit ankesa Nr.264/19 (OE. "Is Company"- Prizren)

Sqarimi 1

Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur shërbime, me vlerë të madhe (kontratë publike kornizë – 36 muaj) dhe kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Vlera e parashikuar për 3 LOT-et 4,000.000 €.

Sqarim ne lidhje me pretendimet ankimore

Përgjigje në pretendimin e parë ankimor

Eksperti i OSHP-së sqaron se AK-Komuna e Prizrenit ka zhvilluar procedurë me vlerë të madhe (kontratë kornizë – 36 muaj)., vlera e parashikuar sipas Njoftimit për Kontratë, FDT-së, Deklaratës së Nevojave dhe Disponueshmërisë së Mjeteve për këtë projekt është 4,000,000.00 €.

Pra, AK nuk e ka ndarëvlerën e parashikuar në LOT-e, që të definohet sa është parashikimi i saktë për LOT 1, LOT 2 dhe LOT 3. Pra, obligim i AK është parashikimin e mjeteve sipas LOT-eve.

Pra, AK-ja nuk e ka ndare vlerën per LOT ne FDT, por e ka leneparashikimin si kompletper 3 LOT-et me vlerë 4,000,000.00 €.

Sipas dëshmive që kemi në dosjen e AK-së, sipas disa kopjeve të bashkangjitura në dosjen e AK-se nga Platforma e E-prokurimit, sipas këtyre AK vlerën e ka ndarë vetëm ne sistem që s'kanepatur mundësi te shohin Operatoret Ekonomik ofertues, por kete mundësi e ka patur vetëm Autoriteti Kontraktues ta shoh. Ndarjen e kontratave në LOT-e e përcaktonNeni 27/A i LPP-së dhe Pikes 2.5 (Ndarja ne Lote) te FDT-së dhe neni 19.2 i RUOPP-se citim: "*19.2 Kurdo që AK ndan aktivitetin në Lote, AK duhet të përcaktoj, në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit, nëse OE do të shpërblehen për: a) të gjitha Lotet; apo b) një numër të caktuar të Loteve.*
Kurdo që AK përzgjedh opsionin (a), AK shpërblen OE për të gjitha Lotet ku është renditur i pari.
Kurdo që AK përzgjedh opsionin (b), AK duhet të përcaktoj në Njoftimin për Kontrate dhe në Dosje të Tenderit numrin maksimal të Loteve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues. Gjithashtu AK duhet te përcaktoj në Dosje të Tenderit kriteret objektive dhe jo-diskriminuese apo rregullat për shpërblimin e loteve të ndryshme, ku aplikimi për përzgjedhjen e kritereve për shpërblim do të rezultonte në shpërblimin e një tenderuesi me më shumë lote se sa numri maksimal").

Pra, AK nuk e ka precizuar edhe ne FDT se sa Lote mund te shpërblehet nje OE.

Sipas sistemit të e-prokurimit AK e ka planifikuar LOT 1 – 1,300,000 €; LOT 2 – 1,500,000 €, dhe LOT 3 – 1,200,000 €. Pra, këto nuk kane qene të precizuara në FDT, por vetëm ne Platformen elektronike (E-prokurim) që s'ka mundur të ketë qasje asnjë OE.

Pretendimi ankimor i OE ankues për këtë pretendim është i bazuar, pasi që AK nuk e ka precizuar vlerën e saktë për LOT në FDT, që është obligim i AK të përcaktohet vlera për LOT, pasi që edhe tenderi është i shpallur për LOT-e. Pra, edhe gjatë fazës së tenderimit AK ka mund ta sqaroj vlerën e parashikuar për LOT 1, LOT 2 dhe LOT 3 përmes platformës elektronike (E-prokurimit).

Përgjigje në pretendimin ankimor

Eksperti i OSHP-së sqaron se OE ankues në pretendimin ankimor ka paraqitur se është shkelur neni 61 i LPP-së dhe Rregullat për Tender jo-normalisht të ulëta(B57), dhe sipas pretendimeve ankimore qëka paraqitur OE ankues se duhet të bëhet kalkulimi i ofertave, sipas formulës siç i përcakton Legjislacioni dytësor B57- Rregullat për Tender Jo-Normalishtë të Ulët. Pra, te shembulli i këtyre rregullave e qartëson se si kalkulohen ofertat me çmim jo-normalisht të ulët(neni 3 i këtyre rregullave):**Neni 3 Informatat e përgjithshme i këtyre rregullave përcakton:**

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen te **gjitha kushtet e mëposhtme:**

i.çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve** të përgjegjshëm;

ii. çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**;
iii. janë dorëzuar të paktën 3 **(tre) tenderë.**

Nr.	Lot 1			
	A	B	C	D
1	**kushti 1** - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 4 oferta	**Pranuar 4 oferta**		
2		***Kompania Regjionale "Ekoregjioni"***	**875,078.88**	
3		***NSH. "Sherbimi"***	**2,500,316.00**	
4		***"IsCompany" shpk***	**1,745,446.20**	
5		***Konz. "EingCom" & "El-bau"***	**744,426.00**	
6				
7				
8		Total (C2+C3+C4+C5)	5,865,267.08	
9		mesatarja (C8/4)	1,466,316.77	
10	**kushti 2** - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	1,127,935.98	ne ketë rast vetëm oferta 2 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11	**kushti 3** – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	pragu 10% (oferta e dyte /1.1)	1,586,769.27	ne ketë rast oferta 2 përmbush edhe kushtin e trete

Pra, sipas këtyre Rregullave dy ofertat me çmim më të lirë **(Ekoregjioni – 875,078.88 € dhe konz. "EingCom& "El-bau" – 744,426.00 €)** janë me çmime jo-normalisht të ulëta, ashtu siç e përcakton Legjislacioni dytësor si në faqen e KRPP-së - Rregullat për Tender jo-normalisht të Ulët (B57).
Pra kushtin e dyte e plotësojnedy OE: **"IsCompany" -1,745,446.20 € dhe NSH. "Sherbimi" - 2,500,316.00€).**

Pra, nga tabela kuptojmë se ofertat nën 1,586,769.27 € janë me çmime jo-normalisht të ulëta.

Pra, edhe pse kanë çmime jo-normalisht të ulëta ("Ekoregjioni" – 875,078.88 € dhe konz. "EingCom& "El-bau" – 744,426.00 €), AK bazuar në nenin 1, 3 dhe neni 4 i Rregullave per Tender Jo-Normalisht te Ulet dhe paragrafi 2 i Neni 61 të LPP-së thotë (citim):
Gjatëpërcaktimitnësenjëtenderështëapodukettëjetëjo-normalishtiulët,autoriteti kontraktuesdotëmerrparasyshshpjegimete dorëzuarangatenderuesi në lidhje me:
1.1 ekonominëeprocesittëprodhimtarisë, tëshërbimevetëofruaradhe/osetë metodave tëndërtimit;
1.2 çfarëdo zgjidhjeteknike qëjanëofruar ose zgjedhur;
1.3 çfarëdokushte veçanërishttëfavorshme qëjanënëdispozicion për tenderuesinpër furnizimineprodukteve, sigurimineshërbimeve,ekzekutimineprojektevetëpunëve dhe/ose ushtrimineaktiviteteve tëndërtimit qëjanëdukeuprokuruar;dhe/ose
1.4 origjinalitetin efurnizimeve,shërbimeve,punës ose punëvetëpropozuara.

*Në lidhje me këto pretendime ankimore të OE ankues ti kërkoj sqarime shtese OE se propozuar për çmime jo-normalishtë të ulëta, sipas **Nenit 4 (Procedura e shqyrtimin InterPartes) të Rregullave per***

Tender Jo-Normalisht te Ulëtdhe Paragrafit 2 te Nenit 61 të LPP-së, dhe AK ti shqyrtoj shpjegimet e dorëzuara nga OE i propozuar.

AK-Komuna Prizren e ka respektuar pjesërisht vendimin e PSH.108/19 duke kthyer lëndën në rivlerësim, por gjatë fazës së rivlerësimit, AK i ka kërkuar sqarime pasi që OE i propozuar ka çmime jo-normalisht te ulëta sipas LPP-së, dhe Rregullave për Tender Jo-Normalisht të Ulet, por OE i propozuar nuk ka dhënë përgjigje ne lidhje me pozicionet, por AK e ka marr parasysh përgjigjen e OE se propozuar edhe pse nuk ishin te sqaruar pozicionet siç ka kërkuar sqarime AK sipas vendimit te PSH.108/19 .

OE ankues pretendon se : Autoriteti kontraktues hapur e ka favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë, sepse e ka shpallur fitues në zonën e parë, ku zona e parë ka 34 km, zona e dytë 31 km dhe zona e tretë 19 km, sipërfaqe të gjelbruara 62000 m^2 zona e parë, zona e dytë 165000 m^2 dhe mirmbajtja e lumbardhit 2200 m^2, dhe zona e tretë 125000 m^2 sipërfaqe të gjelbëruara. Pra është shpallur fitues në zonën ku ka punë më shumë dhe fitim më të madh normalisht, edhe pse ky operator ekonomik ka ofertuar me çmim më të lirë në zonën 3 prej të gjithë ofertuesve dhe ka mundur të shpallet fitues. Këtë veprim AK-ja e ka ndërmarr kuptohet, vetëm që ne mos të jemi fitues i këtij loti (Lot 1).

Duke pasur për bazë këtë fakt, autoriteti kontraktues në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe në kundërshtim me vendimin e panelit shqyrtues, duke dashur ta favorizojë operatorin ekonomik EingCom&ElbauShpk, nuk e kanë shpallur fitues në Lot 3, i cili operator ekonomik ka ofertuar me çmimin më të lirë, se secili ofertues, pra në vlerë prej :440.361.00 €, por është shpallur fitues në Lot 1, ku ka ofertuar me çmim më të lartë se në Lot 3, pra në lot 1 ka ofertuar me çmim prej:875.078.88 €. Këtë veprim, autoriteti kontraktues e ka ndërmarr edhe me qëllimin që, ne mos të shpallem i fitues në asnjërin Lot, sepse nëse kur operatorët e lartpërmendur do të konsideroheshin me çmime jonormalisht të ulëta (për Lot 1) atëherë ne do të duhej të shpalleshim fitues në këtë lot me çmimin prej:1.552.698.80 €.

OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmime jonormalisht të ulëta edhe në shumë pozicione, të cilat mund ti verifikoni edhe ju si OSHP, si p.sh te **tabela C** te mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta në qytet:**pastrimi**, **kositja**, dhe **krasitja**, tek 23 pozicione ka ofruar çmime prej **0.02 cent** (si ka mundësi të kryehen këto shërbime dhe punë me 0.02 cent ?).

Pastaj tek tabela A, nr 2 Kategoria e II-fshirja 12 herë në muaj, **larja-spërkatja tetë** (8) **herë në muaj**, dhe largimi i borës për trotuare në 11 pozicione ka ofruar çmime prej 0.**10 cent**, ndërsa për rrugë 0.30 cent etj.

Tek tabela D (shërbime të veçanta) komplet pozicionet i ka me çmime jonormalisht të ulëta, madje janë çmime absurde, të pa imagjinueshme dhe manipulative.

Tek tabela E (shërbime të veçanta) komplet pozicionet i ka me çmime jonormalisht të ulëta, madje janë çmime absurde dhe të pa imagjinueshme.

Pra pjesën më të madhe të pozicioneve (në ofertë) ka ofruar çmime jonormalisht të ulëta, çmime manipulative që nuk mund të arsyetohen në asnjë mënyrë. Këto çmime nuk ka asnjë mundësi teorike të arsyetohen, për shkak se nuk kanë mbështetje në asnjë manual të çmimeve referente në Kosovë.

Eksperti i OSHP-se sqaron se OE i rekomanduar ka çmime jo-normalisht të ulëta sipas pozicioneve qe pretendon OE ankues.

AK obligohet që ti kërkoj sqarime shtese OE me çmime jo normalishtë të ulëta sipas nenit 61 të LPP-së që sipas paragrafit 2 të nenit 61 të LPP-së dhe Nenit 4 të Rregullave per Tender jo-normalishte te ulet-versioni i korrigjuar.AK i ka kërkuar sqarime sipas nenit te larteshenuar, por OE ankues nuk eshte përgjigjur sipas pyetjes se bere, por ka dhene përgjigje apo arsyetim ne baze te numrit te punetoreve.

Siç pretendon OE ankues per pozicionet me çmimet jo-normalisht të ulëta qëndrojnë

Rekomandojmë që të kthehet lënda në rivlerësim dhe ti kërkohen sqarime shtese OE se propozuar ne te kundertën te refuzohet oferta e tij, kurse ne rast se sjell sqarim shtese OE ankues dhe AK bindet per ato sqarime të pozicioneve qe pretendon OE ankues per çmime jo normalishte te ulëta sipas nenit 61 të LPP-së dhe Rregullave per Tender jo-normalisht te ulet.
AK mund te kërkoj rritjen e sigurimit te ekzekutimit me tepër se 10% te vlerës (psh, mund te kërkoj rritjen e sigurimit te ekzekutimit 20 %;30% apo 40%, aq sa e sheh të arsyeshme AK).

AK-Komuna e Prizrenit i ka rivlerësuar 2 LOT-et, LOT 1 dhe LOT 2, por prap e ka anuluar LOT 3 me arsyetimin se nuk ka mjete buxhetore dhe se vlera e parashikuar për 3 LOT-e është 4,000.000 €.
Vendimi i Paneli Shqyrtues PSH.108/19 ishte qe lenda te kthehet ne rivlerësim 3 LOT-et

Pretendimi i OE ankues është i bazuar

Pretendimi i OE ankues se AK nuk e ka zbatuar plotësisht vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së PSH.nr.108/19 të dt:02.05.2019 na është aprovuar ankesa dhe lënda në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është kthyer në rivlerësim.

Në vendimin e OSHP-së, është konstatuar se autoriteti kontraktues nuk e ka parashikuar vlerën e kontratës sipas loteve, por e kanë parashikuar vlerën vetëm në total dhe duke u bazuar në këtë fakt, paneli shqyrtues ka konstatuar se AK-ja nuk e ka respektuar nenin 56.3 të LPP-së, me rastin e eliminimit tonë në herën e parë.

Gjithashtu në vendimin e OSHP-së, është konstatuar se në bazë të tabelës së Rregullorës për çmime jo-normalisht të ulëta, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë për Lot 1, "Eing-com&El-bau" dhe ofertuesi i dytë me çmim më të ulët "Ekoregjioni" janë më çmime jo normalisht të ulëta.

Pas kthimit të lëndës në rivlerësim, autoriteti kontraktues ka vepruar përsëri në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe në kundërshtim me vendimin e OSHP-së nr.108/19 të dt:02.05.2019 duke e rekomanduar për kontratë të njëjtin operator ekonomik për Lot 1, i cili operator ekonomik ka ofruar çmim jonormalisht të ulët, si në vlerën totale, ashtu edhe në shumë pozicione, ndërsa e kanë anuluar lotin III (tre) pa ndonjë bazë ligjore duke na diskriminuar neve.

Eksperti i OSHP-sësqaron se AK e ka respektuar pjesërisht vendimin e PSH.108/19, sipas sqarimeve qe gjinden ne vendim, pasi qe ne vendim te Panelit Shqyrtues thuhet qe ti kërkoj sqarime sipas paragrafit 2 te nenit 61 te LPP-së dhe nenit 4 (procedura e shqyrtimit – Interpartes) te Rregullave per Tender Jo-normalisht te ulet.
AK i ka kërkuar sqarime OE ankues sipas nenit tëlartëshuar, por OE nuk ka bere ndonjë sqarim te qartë lidhur me pozicionet që pretendon OE ankues.
Te gjitha pozicionet me çmime jo-normalisht te ulëta qëndrojnë ashtu siç pretendon OE ankues.
AK bazuar ne vendimin e Panelit Shqyrtues **PSH.108/19nuk** i ka respektuar : nenin 61; nenin 56.3; nenin 27 te LPP-së dhe piken 2.5 (ndarja ne Lote) te FDT-se dhe nenin 19.2 te RRUOPP.

Pra, ne vendimin e panelit shqyrtues thuhet se është përgjegjësi dhe kompetencë e AK-së t respektohet neni 61 i LPP-së, por AK nuk e ka respektuar vendimin PSH.108/19

Pretendimi i dytë i OE ankues për lot 2, Autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik "Kompaninë regjionale të Mbeturinave Ekoregjioni" me çmim 823.1 8.43 €, ndërsa ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm për shkak se vërtetimin e ATK-së e k ofruar me dt:27.02.2019, kurse shpallja e tij fitues është bërë me dt:25.02.2019, e që kjo bie në kundërshtim me nenin 65 paragrafi 4.8 dhe paragrafi 5 i këtij neni.

Poashtu veprimet e AK-së janë në kundërshtim edhe me nenin 26.8 të Rregullave dhe Udh zuesit operativ për Prokurim Publik (RrUOPP) ku shkruan:
vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim qe ta shpërblej me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit te njoftimit për dhënie të kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo me pak se pesë (5) dit nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. *Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e lis uar në vendin e dytë, si dhe do te konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do t inicioj procedurën për diskualifikim ne përputhje me nenin 99.2 te LPP-se.*

Pra kjo dispozitë është shumë e qartë dhe OE i rekomanduar për kontratë për Lot 2 është d shur të eliminoj këtë operator ekonomik, por çuditërisht e ka favorizuar në këtë mënyrë duke ja p anuar vërtetimin e ATK-së në kundërshtim me dispozitën e lartpërmendur dy ditë pas njoftimit bi vendimin e autoritetit kontraktues (pra njoftimit për dhënie të kontratës), duke vepruar edhe në kund rshtim me nenin 7 të LPP-së, pra duke vepruar në mënyrë favorizuese për OE e rekomanduar për kon tratë dhe njëkohësisht në mënyrë diskriminuese ndaj neve.

Gjithashtu edhe në FDT tek neni 6.4 shkruan qartë "Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet t dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës.Në rast të dështimit n dorëzim të dokumentave të tilla,tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin listuar.

Eksperti shqyrtues i OSHP-së sqaron se lidhur me vërtetimin e ATK-së është ndër kush tet e dhënies së kontratës që të dorëzohen dokumentet para dhënies së kontratës, pra edhe në kriteret e FDT-së dhe Njoftimit për kontratë.
Pra, Autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik "Kompar inë regjionale të Mbeturinave Ekoregjioni" me çmim 823.118.43 €, ndërsa ky operator ekonomik vërteti min e ATK-së e ka ofruar me dt:27.02.2019, kurse shpallja e tij fitues është bërë me dt:25.02.2019, e që jo bie në kundërshtim me nenin 65 paragrafi 4.8 dhe paragrafi 5 i këtij neni.

Pra, siç përcaktohen në nenin 26.8 tëRrUOPP-së: Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përsh tatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin aut riteti kontraktues ka për qëllim qe ta shpërblej me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohe nga tenderuesi para publikimit te njoftimit për dhënie të kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo me pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të a toritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. *Dështimi në dorëzim të dokumenteve të ti la, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do e konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të inicioj procedurën për diskua lifikim ne përputhje me nenin 99.2 te LPP-se.*

Pretendimi ankimor ne lidhje me Vertetimin e ATK-së është i bazuar

Lidhur me pretendimin e OE ankues për çmimin 0.012 €, pretendon se - Ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm edhe për arsye se tek tabela C në 23 pozicione ka ofertuar me më shumë se dy numra pas pikës dhjetore **(0.012)**, kurse kjo nuk ka qenë e parashikuar në dosje të tenderit dmth nuk ka qenë e lejuar, ndërsa neni 18.3 pjesa C e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP) shkruan qartë si në vijim "Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Nëse OE ofron çmim me me shume se dy (2) numra pas pikës dhjetore , oferta e tille do te konsiderohet e papërgjegjshme. Ne rast se AK lejon çmime me më shume se (2) numra pas pikës dhjetore, atëherë AK duhet të cekë këtë decidivisht në Dosjen e tenderit.
Në këtë rast lejimi i ofertimit me më shumë numra pas pikës dhjetore nuk është parashikuar në dosje të tenderit, prandaj ky OE konsiderohet i papërgjegjshëm.

Eksperti i OSHP-se sqaron se nwse nuk i ka twpwrcaktuara ne dosjen e tenderit AK, sipas nenit 18 te RrUOPP-se thotë (citim): *Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet qe te shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Nëse OE ofron çmim me me shume se dy (2) numra pas pikës dhjetore , oferta e tille do te konsiderohet e papërgjegjshme. Ne rast se AK lejon çmime me më shume se (2) numra pas pikës dhjetore, atëherë AK duhet te ceke këtë decitivisht ne Dosjen e tenderit.*
Pra, ne rastin konkret te çmimi i njësisë 0.012 €, mund te merret parasysh 0.01 €, e jo 0.012 € sipas nenit 18.3 te RrUOPP-së. Dhe neni 20.1 (fq.7) i DT-së thuhet (citim): "20.1 Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro **(€) dhe** duhet të përfshinë të gjitha taksat e aplikueshme, detyrat dhe pagesat tjera. **Çmimi i ofertuar** lejohet qeteshenohet me maksimumdy (2) numra pas presesdhjetore. Çdo numer I shenuar pas numrit te dyte (2) nuk do temerret per baze ne llogaritje te vleres se ofertes.

Pretendimi I OE ankuespjeserisht i bazuar
--

<u>Pretendimi i tretë i OE ankues për Lot 3</u>, autoriteti kontraktues e ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se të gjithë ofertat e kanë tejkaluar vlerën e parashikuar të buxhetit, mirëpo kjo arsye nuk është e qëndrueshme, sepse në dosje të tenderit nuk ka pasur parashikim të vlerës dhe të çmimeve për secilin Lot, por ka pasur parashikim të përgjithshëm për të tri lotet, mirëpo këtë veprim AK-ja e ka ndërmarr me të vetmin qëllim që, ne mos të shpallemi fitues sepse operatori ekonomik Eing-Com&ElbauShpk dhe operatori ekonomik Kompania regjionale e Mbeturinave Ekoregjioni kanë ofertuar me çmim jonormalisht të ulët sikurse në Lot 1, kjo mund të vërtetohet me përllogaritjen tabelare, ndërsa ne jemi me çmim më të ulët se operatorët ekonomik tjerë dhe natyrisht ne është dashur të shpallemi fitues të këtij tenderi (Loti III).

Pra autoriteti kontraktues ka vepruar në mënyrë kundërligjore duke manipuluar në kalkulimin e loteve për dhënie të kontratës.

Për lot III anulimin e këtij loti, AK-ja e ka bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 44.7 dhe 8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP) sepse asnjëri nga kushtet që parashihen në këto dispozita nuk janë përmbushur

Në vijim është tabela ku vërtetohet se dy operatorët ekonomik me çmim më të ulët kanë ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta.

Nr.	Lot 3			
	A	B	C	D
1	**kushti 1** - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta	**Pranuar 4 oferta**		
2		1 Kompaninë regjionale të Mbeturinave Ekoregjioni	669.331,60	
3		**2 NSh Shërbimi Tirana P.NR**	**2.008.660,00**	
4		3 IscompanyShpk	1.552.698,80	
5		4 EingCom&ElbauShpk	440.361,00	
8		Total (C2+C3+C4+C5)	4,671.051.40	
9		mesatarja (C4/6)	1,167,762.85	
10	**kushti 2** - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	**pragu 30% (mesatarja /1.3)**	898,279.11	ne ketë rast vetëm oferta 1 dhe 4 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11	**kushti 3** – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	**pragu 10% (oferta e dyte /1.1)**	1,411.544.36	ne ketë rast oferta me nr 4 përmbush edhe kushtin e trete

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se **3 oferta**	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 4 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve** të përgjegjshëm	Oferta e dyte plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih pragun C11
Konkludim	**Oferta me nr. rendor 1 dhe 4 plotësojnë 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulët**	

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u përmendën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është marr parasysh edhe neni 7 i këtij ligji, sepse ne jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa janë favorizuar operatorët ekonomik të rekomanduar për kontratë. Në të njëjtën kohë është vepruar edhe në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së, sepse jemi eliminuar për kërkesa që nuk kanë qenë pjesë e dosjes së tenderit.
Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 61 i LPP-së dhe njëkohësisht edhe rregullorja për çmime jonormalisht të ulëta. Poashtu nuk është zbatuar vendimi i OSHP-së nr.108/19 të dt:02.05.2019, sepse përësëri jemi eliminuar për kërkesa që nuk kanë qenë në dosje të tenderit.

Eksperti shqyrtues i OSHP-së sqaron se OE në pretendimin e tij ankimor edhe në LOT 3 shihet se ka çmime jo-normalisht të ulëta dhe duhet të veproj sikur në LOT-in e parë sipas paragrafit 2 të nenit 61 të LPP-së, ti kërkoj sqarime shtesë OE së propozuar dhe në rast se bindet AKme sqarimet e dhëna nga OE i propozuar mund të kërkoj rritjen e sigurimit të ekzekutimit më tepër se 10% të vlerës (Neni **30.4 të RrUOPP-së**).

Neni 30.4 i RrUOPP-së thotë: *"Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës. Kur përcaktohet përqindja e sigurimit të ekzekutimit, në rasti të kontratave me vlerë të mesme ose të madhe, AK do të siguroj që përqindja mjafton për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata. Autoriteti kontraktues, pasi që të jetë përputhur me nenin 61 te LPP-se, ka mjaft arsye për të besuar se operatori ekonomik e ka dorëzuar një tender të pa-zbatueshëm (jo-normalisht te ulet), gëzon te drejten qe përqindjen e kërkuar te sigurimit te ekzekutimit ta rris për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata".*

Pra, në rast se bindet AK për shkak të çmimeve jo-normalishtë të ulëta sipas nenit **30.4 të RrUOPP-së** AK nëse parasheh se mund të shkëputet kontrata AK mund të kërkoj rritjen e sigurimit më shumë se vlera e kërkuar.

Sipas paragrafit 2 te nenit 61 te LPP-së dhe nenit 4 (procedura e shqyrtimit – Interpartes) te Rregullave per Tender Jo-normalisht te ulet.

AK i ka kërkuar sqarime OE ankues sipas nenit të lartëshuar, por OE i propozuar nuk ka bere ndonjë sqarim te qartë lidhur me pozicionet që pretendon OE ankues.

Te gjitha pozicionet me çmime jo-normalisht te ulëta qëndrojnë ashtu siç pretendon OE ankues.

AK bazuar ne vendimin e Panelit Shqyrtues PSH.108/19.

Pretendimi ankimor i bazuar.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet e bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet ankimore),propozojmë te anulohet Vendimi i AK dhe lënda te kthehet ne rivlerësim dhe të zbatohet vendimi i PSH.108/19 për tri (3) LOT-et..